



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA E PËRMBARIMIT TIRANË

Nr. 22347 Prot

Tiranë, më 14 / 10 / 2025

V E N D I M

NR. 22347 , DATË 14 . 10 .2025

P Ë R

“SHPALLJEN E SHITJES NË ANKAND E DYTE TË PASURISË SË
PALUAJTSHME”

Unë Pjetër Caka me funksion Kryetar pranë Zyrës Përmbarimore Tiranë pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore në zbatim të Vendimit Nr. 1609 Datë 13.04.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

KONSTATOVA :

Se është depozituar pranë Zyrës së Përmbarimit Tiranë kërkesa e kreditorit Fran Molla së bashku për Vendimin Nr. 1609 datë 13.04.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane me palë :

Kreditor: Fran Molla
Debitor Mirson sh.p.k. Nipt K815110015A
Me objekt: Kthim shume h

Në kushtet kur për ekzekutimin e vendimin Nr 1609 Date 13.04.2023 Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tirane është vendosur sekuestro conservative , **pasurise me** Nr 60/105 +3-10, Vol.33, fq.99, Zk 2679,lloje apartament me siperfaqe 112.3 m2 me adrese Mezez Tirane ne pronesi te shoqerise Mirson sh.p.k Nipt K815110015 A

Me daten 09.10.2025 është zhvilluar ne ambjentet e Zyrës Përmbarimore Tiranë Ankanti I dyte per shitjen e pasurise se paluajtshme me Nr 60/105 +3-10, Vol.33, fq.99, Zk 2679,lloje apartament ne pronesi te shoqerise Mirson sh.p.k Nipt K815110015 A , në me cmimin fillestar në vlerën **4,312,000 leke (kater milion e treqind e dymbedhete mije)) Lekë. Ne ankant nuk u paraqit asnje ofertues.**

Bazuar në nenin 577 të Kodit Procedurës Civile kur në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë brenda 10 ditëve nga dita e përfundimit të ankandit të parë përmbaruesi gjyqësor përcakton çmimin e ri të sendit të sekuestruar të pasurisë së paluajtshme një apartament banimi me Nr. 60/105+3-10, Vol. 33, fq. 99, Zk 2679, me

Adresa: Sheshi “Mustafa Qemal Atatürk”, Tiranë

Tel: 04271756

sipërfaqe 112.3 m² me adresë Mëzez Tiranë në pronësi të Shoqërisë Mirson sh.p.k. me Nipt K815110015A jo më të ulët se 10% të çmimit fillestar të caktuar në ankandin e parë, Pallati ku ndodhet apartamenti është në ndërtim e sipër.

Caktimin e çmimit të ri të sendit të sekuestruar të pasurisë së paluajtshme një apartament banimi me Nr. 60/105 +3-10, Vol. 33, fq. 99, Zk 2679, me sipërfaqe 112.3 m² me adresë Mëzez Tiranë, në pronësi të Shoqërisë Mirson sh.p.k. Nipt K815110015A në shumën 3,880,800 lekë lekë.

Për këtë arsye, në mbështetje të nenit 567, 568, 569 e 570 të Kodit të Procedurës Civile, ligjit Nr.8/2023 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Sherbimit të Permbarimit Gjyqësor" Për caktimin e çmimit të pasurisë së paluajtshme" me Nr 60/105 +3-10, Vol.33, fq.99, Zk 2679,lloje apartament me siperfaqe 112.3 m2 ne pronesi te Shoqerise Mirson sh.p.k Nipt K815110015 A

V E N D O S A

1.Shpalljen e shitjes në ankandin e dytë të pasurisë së paluajtshme "me Nr 60/105 +3-10, Vol.33, fq.99, Zk 2679,lloje apartament me siperfaqe 112.3 m2 me adrese Mezez Tirane ne pronesi te shoqerise Mirson sh.p.k Nipt K815110015 A , në vlerën 3880800 lekë (tre milion e teteqind e tetedhjetë mijë e teteqind) Lekë Shitja e pasurisë në ankand do të bëhet ditën e **Hene**, me datë **17.11.2025**, ora **16.15**, në Zyrën e Përmbarimit Tirane. Çdo ofertues që është i interesuar për blerjen e pasurisë/pasurive në ankand, është i detyruar të paraqitet personalisht dhe/ose nëpërmjet përfaqësuesi të tij/saj me prokurë, si dhe të dorëzojë (brenda në zarf të mbyllur) në zyrën e Zyrën e Përmbarimit Tirane deri në orën 16:00, këto dokumenta:

- a) kërkesën e tij/saj për pjesëmarrje në ankand;
 - b) faturën bankare të 10% të garancisë për pjesëmarrje në ankand (në origjinal);
 - c) dokumentin e identifikimit (Kartë identiteti ose Pasaportë). Në rast se ofertuesi është person juridik, përveç dokumenteve që paraqet çdo person fizik, përfaqësuesi ligjor duhet të paraqesë statusin, aktin e themelimit të personit juridik, një kopje të ekstraktit historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe një kopje të certifikatës së regjistrimit dhe/ose dokumente të tjera që parashikon ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
1. Çdo ofertues që merr pjesë në ankand, përpara fillimit të procedurave të shqyrtimit të ofertave, në **datën 17.11.2025 ora 16.15**, është i detyruar të depozitojë si garanci në llogarinë prane **Credins Bank ne llogarine AL 61212110160000000000818181** te Zyres se Permbarimit Tirane, një shumë të hollash të barabartë me 10 % të çmimit të pasurisë/pasurive të caktuar në shpallje. Kreditori nuk le garanci, në rast se kredia e tij e kalon masën e garancisë.

2. Debitori dhe/ose përfaqësuesi i tij ligjor, përmbaruesi gjyqësor, si edhe personat e tjerë që listohen në nenin 709 të Kodit Civil, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ankand. Kur sendi blihet nga një person që nuk ka të drejtë të marrë pjesë në ankand, shitja është e pavlefshme. Në këtë rast, shuma e lënë si garanci nga blerësi kalon në dobi të shtetit dhe sendi me kërkesë të secilit kreditor mund të shitet përsëri në ankand, duke vepruar sipas rregullave të caktuara në Kodin e Procedurës Civile.
3. Gazetës "Telegraf" dhe Gazetës "Panorama", sipas detyrimit që rrjedh nga neni 568 i Kodit të Procedurës Civile, këtë vendim detyrohen ta publikojnë **5(pesë) ditë me radhë**, në gazetatat e tyre. Për shërbimin e kryer, të lëshohet faturë tatimore shitje në emër të blerësit **Fran Molla**. Likujdimi i faturës tatimore, do të bëhet nga kreditori **Fran Molla**, pasi Gazeta "Telegraf" dhe Gazetën "Panorama", të paraqesin tek zyra e përmbarimit një kopje të gazetave në formatin A4, ku të vërtetojnë se është publikuar vendimi **5(pesë) ditë me radhë**.
4. Ky vendim hartohet në **9 (Nëntë) kopje**. Një kopje administrohet në dosjen përmbarimore **1(një)** kopje afishohet në ambientet e Zyrës e Përmbarimit Tirane; **1(një)** kopje afishohet në vendin ku ndodhen pasuritë e paluajtshme; **1(një)** kopje i njoftohet debitorit; **1(një)** kopje i njoftohet kreditorit; **2(dy)** kopje iu njoftohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane dhe Bashkisë Tirane, për afishim në ambjentet e tyre publike, si dhe **2(dy)** kopje iu njoftohen për publikim, **Gazetës "Telegraf" dhe Gazetës "Panorama"**.

KRYETARI I ZYRËS
PJETER CAKA

